



**UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" GJILAN**

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës  
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

---

Ref.nr. 02 / 3185      Datë 16 / 12 / 2024

---

Në bazë të nenit 23 paragrafi 1 pika 1.3 dhe 1.8 të Statutit të Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan, si dhe bazuar në rregullore (QRK) Nr. 06/2023, për kompensimin për udhëtime zyrtare dhe shpenzim të përfaqësimit, Këshilli Drejtues i Universitetit, në mbledhjen e dytë (-II-) mbajtur më datë 10.12.2024, nxori këtë:

**Rregullore  
për caktimin e lartësisë së shpenzimeve të përfaqësimit  
( drekave dhe darkave zyrtare )**

**Neni 1  
Qëllimi**

Kjo Rregullore ka për qëllim menaxhimin sa më efikas të buxhetit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan, përcaktimin e procedurave dhe lartësisë së shpenzimeve të përfaqësimit (drekat apo darkat zyrtare) që shtrohen me rastin e pritjes së delegacioneve brenda dhe jashtë vendit, komisionet dhe grupet punuese, kremtimi i përvjetorëve, konferencat shkencore, tryezat debatuese etj.

**Neni 2  
Përkufizimet**

Darkë ose drekë zyrtare konsiderohet kur në të marrin pjesë së paku tre persona. Shpenzime të përfaqësimit (drekat apo darkat zyrtare) të rektorit konsiderohen shpenzimet tek a tek me palën tjetër dhe shpenzimet e vozitësve eventualisht.

**Neni 3**

Barasvlershëm-ia e shpenzimeve për përfaqësim ( dreka dhe darka zyrtare) të pozitive sipas rregullores së Qeverisë në Republikën e Kosovës nr.06/2023 dhe organogramit e UKZ-së

Barasvlershmëria e Pozitave në UKZ për shpenzimet përfaqësim (dreka dhe darka), janë si në vijim:

<b>Pozita sipas rregullores së Qeverisë së Kosovës nr. 06/2023</b>	<b>Pozita sipas organogramit në UKZ</b>
Ministri	Rektori
Zv. Ministri	Prorektorët
Sekretarët e përgjithshëm të ministrive	Sekretari i përgjithshëm i UKZ,
Drejtorët ekzekutive të agjencive	Dekanët e njësive akademike,
Drejtorët e departamenteve	Drejtorët e departamenteve
Këshilltari politik i ministrit	Këshilltari i rektorit

#### **Neni 4**

#### **Të drejte për shpenzimet e përfaqësimit në Universitetin Publike “Kadri Zeka”**

Zyrtarët publikë që paguhen nga buxheti i UKZ kanë të drejtë kur lejohet nga dispozitat e kësaj rregullore për shpenzime të përfaqësimit.

- Rektori
- Prorektorët
- Sekretari i përgjithshëm i Universitetit
- Dekanët e fakulteteve
- Drejtorët në administratë
- Këshilltari i Rektorit

#### **Neni 5**

#### **Vlera e shpenzimeve të përfaqësimit (dreka dhe darka zyrtare)**

Në varësi nga arsyet dhe nevojat e punës, vlera maksimale e shpenzimeve mujore të përfaqësimit është si në vijim:

Nr.	Emërtimet	Shuma / deri në €	
1	Rektori	500.00€	në muaj
2	Prorektorët	200.00€	në muaj
3	Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit	100.00€	në muaj
4	Dekanët	70.00€	në muaj
5	Drejtorët e departamenteve	50.00€	në muaj
6	Këshilltari i Rektorit	50.00€	në muaj

#### **Neni 6**

#### **Kompensimi për përfaqësim në komisione dhe grupe punuese**

Kompensimi për përfaqësim sipas këtij neni nënkupton shpenzimet e udhëheqësit të grupit punues / kryesuesit të komisionit për nevojat e punës së këtyre grupeve.

Shpenzimet e përfaqësimit të këtyre grupeve u lejojnë i vlerën maksimale deri në 100.00 euro në muaj e të cilat duhen të arsyetohen me listë të pjesëmarrësve dhe një raport pune.

Këto shpenzime mbulohen në baze të kërkesës nga kryesuesi / udhëheqësi i grupit punues apo komisioni. Këto shpenzimet kërkojnë aprovim paraprak (kërkesë për lejim) nga sekretari i përgjithshëm i UKZ

### **Neni 7**

#### **Tejkalimi i shpenzimeve të përfaqësimit (dreka dhe darka zyrtare)**

Shpenzimet e përfaqësimit të përcaktuar me këtë rregullore, nuk mund të tejkalohen.

Çdo tejkalim nga shuma e lejuar mbulohet nga zyrtari përkatës që ka tejkaluar shumën.

Shpenzimet e përfaqësimit (dreka dhe darka zyrtare) nuk mund të akullohen dhe të barten në muajin pasardhës.

Përbashimisht, në raste e veçanta të tejkalimit të shumës së lejuar sipas nenit 3 të kësaj rregullore, kërkohet miratim i veçantë nga Këshillit Drejtues.

### **Neni 8**

#### **Procedimi i pagesës**

Të gjitha shpenzimet e përfaqësimit duhet të arsyetohen me faturë përkatëse origjinale, në pjesën e pasme të faturës me emrat e personave të përfshirë në drekë/darkë zyrtare dhe të nënshkruhen nga personi i autorizuar, ku do të ceket edhe qëllimi i shpenzimit.

Shpenzimet e përfaqësimit (dreka dhe darka zyrtare) duhet të planifikohen në buxhetin e UKZ dhe të aprovohen çdo vit fiskal.

Shpenzimet e përfaqësimit (dreka dhe darka zyrtare) duhet të arsyetohen me fatura të cilat paguhën përmes transfereve bankare në llogarinë rrjedhëse të përfituesit të shërbimit.

Ekzekutimi i transferimit bankar të mjeteve kryhet nga Zyra për Buxhet dhe Financa e UKZ.

### **Neni 9**

#### **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga ana e Këshillit Drejtues të Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan.

Kryesuesi i Këshillit Drejtues të UKZ-së



Dr. Techn. Ilir GJINOLLI